



Buletini Mjedisor

ARRITJET E MINISTRISË SË MJEDISIT NË 300 DITË



Analiza 300 ditore e Ministrisë së Mjedisit

Gjatë muajit korrik, Ministria e Mjedisit, në ambjentet e Muzeut Kombëtar, organizoi analizën 300 ditore të punës së bërë në këtë institucion.

Në takim merrnin pjesë Zëvendëskryeministri z. Niko Peleshi, Ministri i Mjedisit z. Lefter Koka, të gjithë punonjësit e Ministrisë së Mjedisit dhe të institucioneve të saj të varësisë. Në këtë analizë të punës së bërë, ishin të ftuar dhe donatorët që punojnë në fushën e Mjedisit. Fjalën hyrëse, të kësaj analize 300 ditore, e mbajti zëvendëskryeministria e Ministrisë së Mjedisit znj. Oljana Ifti, e cila theksoi rëndësinë e madhe që merr mbrojtja e Mjedisit krahasuar kjo me të gjitha fushat e tjera në vend.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, z. Alqi Bllako, bëri një prezantim të plotë të situatës së gjetur dhe punës së bërë deri tani nga

gjithë stafi i kësaj Ministrie. Prezantimi i z. Bllako sillte në vëmendje të pjesëmarrësve, krahasueshmërinë e dy realiteteve: asaj të gjetur dhe realitetit të ndërtuar në këto 300 ditë të para të Qeverisjes. Ai theksoi punën e bërë nga stafi i Ministrisë së Mjedisit në të gjitha drejtimet, jo vetëm atë të plotësimit të boshllëqeve ligjore të mbartura nga e kaluara, por dhe të politikave përmirësuese të hartuara dhe të implementuara në këto 300 ditë.

Nga z. Juljan Beqiraj, Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit u prezantua puna e bërë në funksion të monitorimit të parametrave të Mjedisit, si dhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve që ofron kjo Agjenci për biznesin. Në koherencë me prezantimin e z. Bllako, edhe z. Beqiraj solli para të pranishmëve një tablo krahasuese të situatës së gjetur në Agjencinë e Mjedisit në njërin anë dhe punën e bërë për të ndryshuar dhe ridimensionuar në një Agjenësi Kombëtare Mjedisi.

Më pas fjalën e mori z. Ergys Agasi, Drejtori i Inspektoriatit të Mjedisit dhe Pyjeve, i cili solli para

të pranishmëve në mënyrë të përmblodhur, aksionet që ishin ndërmarrë nga Inspektoriatit për t'i dhënë fund abuzivizimit dhe shkeljes së ligjit nga aktivitetet e ndryshme që kanë ndikim në mjedis.

Fjalën e përmbyllëse të analizës 300 ditore e mbajti Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, i cili theksoi se “Në vetëm 300 ditë, Ministria e Mjedisit realizoi një sërë reformash thelbësore në fushën e pyjeve, ajrit, ujit dhe mbetjeve, reforma këto me impakt të drejtpërdrejtë në jetën e çdo shqiptari.

Gjatë këtij rrugëtimi 300 ditor, arritëm ta vendosnim mjedisin në vëmendje të çdo shqiptari.

Me mijëra vullnetarë, nxënës, studentë, punonjës, qytetarë të thjeshtë iu bashkuan nismave të Ministrisë së Mjedisit. Sot, të gjithë ne, jemi shumë më të ndërgjegjshëm mbi rëndësinë e mbrojtjes së Mjedisit në të cilin jetojmë. Pavarësisht se afrimi me standartet mjedisore më të mira europiane mbetet ende larg, ne vazhdojmë punën tonë të bindur se së bashku do t'ia dalim.” e mbylli fjalën e tij z. Koka, Ministër i Mjedisit.

Të pranishmit i përshëndeti për punën e bërë, dhe zëvendës Kryeministri zoti Niko Peleshi.

MJEDISI NË 300 DITËT E ARDHËSHME

Pas analizës së 300 ditëve të para, Ministria e Mjedisit në bazë të objektivave të shpalluara që në ditët e para të qeverisjes Rama, përcaktoi aktivitetet që do ndërmerren në vijimin e punës për 300 ditët në vijim. Këto aktivitetet janë detajuar për fushat në vijim.

- ⇒ Menaxhimi i integruar i mbetjeve
- ⇒ Menaxhimi i cilësisë së ajrit
- ⇒ Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe zonave të mbrojtur
- ⇒ Mbrojtja e pyjeve dhe kullotave
- ⇒ Menaxhimi i integruar i burimeve Ujore.

Çdo drejtori dhe sektor i Ministrisë së Mjedisit dhe institucioneve të saj të varësisë tashmë ka filluar punën për realizimin e objektivave të mësipërm në 300 ditë e ardhëshme.

NË KËTË NUMËR:

300 DITËT E MINISTRISË SË MJEDISIT	Fq. 1
LEJET MJEDISORE QËSHOR 2014	Fq. 2,3
PROJEKTE REHABILITUESE MJEDISORE	Fq. 3
UNESCO MIRATON STATUSIN "LIQENI OHËR - PRESPË"	Fq. 4

“Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit, dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Europian. Përbushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitur dhe bashkërenduar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik”.

LEJET MJEDISORE QERSHOR 2014

NR	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDNDODHJA	VENDIMI
1.	SANTARA	Linjë përpunimi inertesh	Prezë, Tiranë	Refuzohet
2.	DODONA	Prodhim inertesh	Lukovë, Borsh, Vlorë	Refuzohet
3.	DEKOLL	Impiant per material lidhes, llac dhe bojra per industrine e ndertimit	Xhafzotaj, Durrës	Miratohet
4.	C & S ENERGY	Ndryshim i projektit të Hec-it	Librazhd, Elbasan	Refuzohet
5.	SECURITY FORCE - 98	Prodhim dhe ambalazhim i pijeve joalkolike	Lanabregas, Tiranë	Refuzohet
6.	HEC LASHKIZA	ndertim me koncension i HEC Lashkiza 1/2	Peshkopi, Dibër	Refuzohet
7.	ALBA MANUFACTURING	Pastrim, larje bidonash inoksi.	Shkozë, Durrës.	Refuzohet
8.	REDI	III.2.B Grumbullim,transportim, ruajtje, përpunim i mbetjeve metalore(skrap)	Durrës	Refuzohet
9.	BAHITI PLAST	III.2.B Grumbullim, transportim, ruajte dhe riciklim i mbetjeve plastike	Porto Romano, Durrës.	Miratohet
10.	KOKA	Shfrytëzim i mineralit krom	Qarku Shkodër.	Miratohet
11.	KURUM INTERNATIONAL SH.A	Depozita të gazit të lëngshëm	Ish Metalurgjiku, Elbasan.	Miratohet
12.	ENERGY DEVELOPMENT GROUP	Shfrytëzim i rërave bituminoze.	Fier	Miratohet
13.	ALBA-CHINA bëhet Fat-Alkom Beton Albania	Ndryshim emri i subjektit në Fat- Alkom Beton Albania	Elbasan	Miratohet
14.	DIANI	Nxjerrje e mineralit të kromit	Bulqizë, Dibër	Refuzohet
15.	DOBRUSHI 2010	Shfrytëzim i mineralit gur gëlqeror	Dorezi, Berat	Refuzohet
16.	FUSHA	III.2.B Grumbullimtransportim ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme	Shkozë, Tiranë	Refuzohet
17.	KENDREVIC ENERGY	Ndërtim me koncension H/C Driza	Tepelenë, Gjirokastrë	Refuzohet
18.	RAL	Shfrytëzim mineralit krom	Krastë, Dibër	Refuzohet

PROJEKTE REHABILITUESE MJEDISORE

FILLON PUNA PËR REHABILITIMIN E PARKUT TË LURËS

Ky projekt është hartuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe kap vlerën 16,502,277 lekë.

Projekti pritet të bëjë rehabilitimin e infrastrukturës dhe sinjalistikës, ripyllëzim, ndërtimin e pritave, pastrimin nga mbeturinat të sipërfaqeve rrotull liqeneve dhe të parkut, në tërësi. Rehabilitimi i rrugës ekzistuese automobilistike me një gjatësi prej 20 km do të kryhet përmes këtij projekti të financuar nga buxheti i Ministrisë së Mjedisit, duke filluar nga Fushë Lura e deri në kufinj të parkut me rrethin e Matit. Tabela informuese për vizitorët do të vendosen në park, përgjatë rrugës që lidh dy skajet e parkut, në vende të hapura dhe

kryqëzime rrugësh e shtigjesh. Projekti përfshin edhe pastrimin nga mbeturinat të 8 Liqeneve të Lurës, si edhe ripyllëzim.

PROJEKTI I RIPPYLLËZIMIT NË PARKUN KOMBËTAR "MALI I DAJTIT"- BOVILLA

Ky projekt është hartuar nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor Krujë dhe kap shifrën prej 7,967,850 lekë.

Projekti pritet të kryejë ripyllëzimin me pisha të llojit mesdhetar të një sipërfaqjeje prej 25 ha në zonën e Bovillës, pjesë e Parkut Kombëtar "Mali i Dajtit". Ky projekt ripyllëzimi do të kryhet në periudhën shtator-nëntor dhe synon mbrojtjen e basenit ujëmbledhës të Bovillës, përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm për banorët e qytetit të Tiranës dhe zonave përreth.

PROJEKTI REHABILITUES NË PEISAZHIN E MBROJTUR "LUMI I BUNËS-VELIPOJË"

Projekti për rehabilitimin e Peisazhit të Mbrojtur "Lumi i Bunës-Velipojë" është hartuar nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor Shkodër dhe arrin vlerën 10,003,544 lekë.

Sipas planifikimeve ky projekt synon të realizojë kontroll dhe mbrojtje më të mirë të sipërfaqes së këtij peisazhi, e për rrjedhojë do të ndërtojë një rrethim cilësor të gjithë sipërfaqes së mbrojtur, nga derdhja e lumit Buna deri në Velipojë, në një gjatësi prej 2.82 km.

LEJET MJEDISORE QERSHOR 2014

NR	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDODHJA	VENDIMI
1.	XHAJS TIRANA	Impiant për fraksionimin inertesh mali	Zall Herr, Tiranë	Refuzohet
2.	ZGURI	Shfrytëzim i mineralit krom	Martanesh, Dibër	Refuzohet
3.	EUROFISH	Prodhim dhe përpunim peshku	Shëngjin, Lezhë	Miratohet
4.	A KLAS BETON ASFALT	Impiant asfaltt-betoni	Shënkoll, Lezhë	Miratohet
5.	PETROL GAZ TIRANA	Impiant për magazinimin e gazit të lëngshëm	Mëzez, Tiranë	Miratohet
6.	PREMTI	Impiant fraksionimi inerte të gurit gëlqeror	Lukovë Sarandë	Miratohet
7.	EDILE VESELI CONSTRUCTION	Shfrytëzim I gurit gëlqeror	Borizanë, Krujë	Refuzohet
8.	BARDHGJANA	HEC	Fan, Mirditë	Miratohet
9.	ARDJAN HALILI	Prodhim geleror mbi 100ton/vit	Fushë Krujë, Durrës	Refuzohet
10.	DRINI-A	Impiant fraksionimi te inerteve lumore	Shkodeë	Refuzohet
11.	ERZENI SHPK	Perpunim qumeshti	Kutali, Berat	Miratohet
12.	ARTEMIS FARM	III 2B Grumbullim, përpunim i mbetjeve ushqimore të llojeve të ndryshme	Vaqarr, Tiranë	Refuzohet
13.	A.E.K. & COM	Pastirm i rrugëve dhe i mjedisit nga mbetjet e ngurta urbane të qytetit dhe pëndrave të fshateve të Himarës dhe seleksionimi i tyre sipas përberjes	Shales, Market, Sarande, Vlore	Refuzohet
14.	VEGA	Impiant për fraksionimi të inerteve dhe prodhimi të betonit	Kalosh, Kukës	Refuzohet
15.	FORALB ALABASTER	Kariera e shfrytëzimit të gipsit alabastër	Objekti Mengaj , Kavajë	Refuzohet
16.	BASHKIA PRRENJAS	Landfill i mbetjeve urbane të Bashkisë Prrenjas	Prrenjas, Librazhd, Elbasan	Refuzohet
17.	MIN-EX	Shfrytëzim i mineralit krom	Bytyc, tropojë, Kukës	Refuzohet
18.	KOMUNA SHALE	Ndertim i ujesjellesit të fshatit Theth	Theth, Shale, Shkodër	Refuzohet
19.	KLEVI-10	Shfrytëzim i mineralit të kromit	Bulqizë, Dibër	Miratohet

UNESCO MIRATON STATUSIN “LIQENI OHËR – PRESPË, REZERVË NDËRKUFITARE BIOSFERIKE”



Vendimi është marrë në sesionin e 26-të të Këshillit Ndërkombëtar të Koordinimit “Njeriu dhe Biosfera”, të mbajtur në Jönköping të Suedisë më 11.06.2014.

Në këtë sesion, Këshilli Ndërkombëtar i Koordinimit “Njeriu dhe Biosfera” (MaB) i UNESCO-s ka aprovuar propozimin e Ministrisë të Mjedisit të Shqipërisë për njohjen e ekosistemit Ohër – Prespë, Rezervë Ndërkufitare Biosferike. Me vota të plota të 12 anëtarëve të Këshillit, Ohër – Prespa ka tashmë statusin e ri, përmes të cilit do të sigurohet një mekanizëm që ruan balancën midis zhvillimit të qëndrueshëm të këtij rajoni me mbrojtjen e resurseve natyrore, duke ndihmuar në përmirësimin e menax-

himit, forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar, planifikimin e integruar dhe forcimin e zbatimit ligjit për zonat e mbrojtura.


Gjatë takimit me Drejtoreshen e UNESCO-s, znj. Irina Bokova, zhvilluar në mars të këtij viti në Tiranë, Ministri i Mjedisit theksoi vlerat e mëdha të vendit tonë dhe të natyrës së bukur shqiptare, duke kërkuar mbështetjen e UNESCO-s për promovimin e kësaj pasurie në mbarë botën.

Vendimi i Këshillit Ndërkombëtar të Koordinimit “Njeriu dhe Biosfera” është një vendim pozitiv, i cili ndihmon Ministrinë e Mjedisit në punën e saj, por edhe rrit detyrimet për mirëadministrim dhe zhvillim të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe

përmirësim të cilësisë së jetës së komuniteteve lokale.

Zona Ndërkufitare Biosferike përfshin pjesën Shqiptare dhe Maqedonase të basenit të Ohrit, pjesën e Prespës së Madhe Shqipëri – Maqedoni, si dhe pjesën shqiptare të Prespës së Vogël, duke përfshirë edhe zonën malore, si kontribuese të furnizimit me ujë të liqenit. Sipërfaqja nën statusin e UNESCO-s Ohër – Prespë Rezervë Ndërkufitare Biosferike arrijn një sipërfaqe prej 446,224.52 ha ose 4,462.24 km².

Liqenet e Ohrit dhe Prespës janë vlerësuar si thesaret biologjike të Ballkanit, pasi të dy liqenet janë njohur si pika të nxehta të diversitetit biologjik, për shkak të specieve endemike, që gjenden vetëm në këto ekosisteme.



THËNIA E MUAJIT

“Njerëzit fajësojnë mjedisin e tyre, por është vetëm një njeri për tu fajësuar ~ dhe vetëm një - ata vetë.”

Robert Collier

SEKTORI I TRANSPARENCËS DHE KOMUNIKIMIT

Email: info@moe.gov.al

NGA AKTIVITETET E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE



Në kuadër të zbatimit të projektit “Së bashku, një sy për mjedisin”, Qendra e Informacionit Aarhus, Shkodër (AIC

Shkodër), në bashkëpunim me pjesëtarët e tjerë të rrjetit të vigjilencës mjedisore organizuan trajnime mbi të drejtat mjedisore për komunitetet e prekura nga kompanitë ndotëse në disa qytete të vendit si në Elbasan, Berat, Fushë-Krujë, Vlorë.

Trajnimi i parë u organizua me komunitetin e Uznovës (Berat), datë 23 korrik 2014. Në këtë trajnim të ndërmarrë dhe me bashkëpunimin e shoqatës “Për mirëqenie sociale dhe mjedisore-Berat” morrën pjesë rreth 30 banorë të zonës

Ky komunitet është i prekur nga ndotjet që shkakton fabrika e lëkurës e cila zhvillon veprimtarinë e saj në këtë zonë. Objektivi kryesor i trajnimit ishte dhënia e ekspertizës për të drejtat që kanë këta banorë në kuadër të Konventës së Aarhusit për të ushtruar të drejtat e tyre në marrjen e informacionit për shkallën e ndotjes që shkakton fabrika, si dhe mjetet e tjera ligjore për t'u bërë pjesë e vendimmarrjes mjedisore apo dhe për t'ju drejtuar gjykatës kur i mohohen këto të drejta nga autoritetet vendimmarrëse. kjo me qëllimin final që komuniteti të

ndërgjegjësohet dhe të Metoda e trajnimit ishte ideuar në forma interaktive, me anë të ushtrimeve në grup dhe trajtimit të rasteve konkrete në mënyrë që pjesëmarrësit të kuptonin praktikisht hapat që duhen ndërmarrë për kërkimin e informacioneve mjedisore, për përfshirjen e tyre në vendim-marrje mjedisore dhe për procedurat e ankimimit administrativ dhe gjyqësor.

Gjatë trajnimit, çështja e fabrikës së lëkurës ishte rasti real studimor. Vetë të pranishmit sollën shëmbuj të dëmimit të shëndetit nga ndotje në ajër, në lum, në tokat bujqësore që shkaktonte fabrika. U theksua shumë, gjatë trajnimit, roli që vetë banorët mund të luanin për ndryshimin e situatës mjedisore në zonën ku ata



ngritën para këtij komisioni një sërë çështjesh shqetësuese për ta, në lidhje me sektorin e Ujit.

Në këtë takim merrnin pjesë përveç deputetëve të të gjitha forcave politike dhe përfaqësues të Kryeministrisë, Sekretariatit Teknik për ujin dhe Ministrisë së Transportit

dhe Infrastrukturës, Z. Ylli Manjani.

Në takim u mbajt një qëndrim i shoqërisë civile për problematikën e ujit në Shqipëri. Shoqatat mjedisore kishin ndërmarrë prej 6 muajsh një takim me profesionistë të ndryshëm në të gjitha basenet e vendit dhe kishin parë mungesa të ndryshme si në pjesën e politikave ashtu edhe në zbatueshmërinë e tyre. Ata në letër e dorëzuar pranë këtij komisioni kishin detajuar problematikën e menduar prej tyre që haset në këtë fushë. Gjithashtu ata shprehën dhe sygerimet e tyre për përmirësimin e situatës që ishin si më poshtë :

1. Uji duhet të menaxhohet “nga një dorë” e vetme. Ngritja e një Agjencie për Menaxhimin e Burimeve Ujore mund të sjellë në një menaxhim më të qartë në ujin si burim natyror dhe ujin si e mirë publike;

2. Përgjegjshmëria dhe sjellja e biznesit duhet fuqizuar më tej. Të gjitha industritë që përdorin ujin duhet të sigurojnë përdorim eficient të tij dhe trajtim përfundimtar të ujërave të përdorur dhe rehabilitim të burimit sa here është e kërkuar dhe e mundur;

3. Ndalimin e investimeve në vepra të mëdha si hidrocentralet deri në përgatitjen e VSM dhe sigurimit të balancës ujore, kadastrës dhe strategjisë së ujit.